Naser Miftari

Rrugët e jetës

/poezi/

Editor
Azam Dauti

Recensent
Rrahim Ganiu

Naser Miftari

RRUGËT E JETËS

/poezi/

Shkupi
Shkup, 2O18

Ashtu

Ashtu si më sheh
të tillë më percepto.
Ashtu si më dëgjon
të tillë më kupto.
Buzëqeshjen,të tillë prano,
më kot, mos medito.
Ai apo ky,
ashtu apo kështu,
ka bërë apo do të bëjë...
Për të keq,
mendjen mos e vrit.
Kultivo të mirën,
të bukurën..., me dashuri.
Flijo të keqen,
për hirë të ferrit.
Ndriço dashurinë,
për hirë të parajsës.
Nxit adhurimin,i respektuar je.
Urretja s'ka vend në Ty.

Aty

Aty ku fjala dëgjohet
Aty ku mirësia kultivohet
Aty ku respekti mësohet
Kënga e trimërisë, aty këndohet.

Aty ku djalli urrehet
Aty ku e keqja ndërpritet
Aty ku njerëzia vërehet
Kënga e trimërisë, aty këndohet.

Aty ku dashuria lulëzon
Aty ku lumturia gjallëron
Aty ku zemra gëzon
Kënga e trimërisë, aty këndohet.

Aty ku djersa sajohet
Aty ku nderi lavdërohet
Aty ku mençuria farkohet
Aty ku gëzimi lartësohet
Kënga e trimërise, aty këndohet.

Loti

Loti i çiltër u rrokullis,
me vrap iku nga qerpiku,
mbi buzë e mjekërr u përmbys,
i hidhëruar u tret diku.

...pas fjalës së ëmbël,
...pas të bukurës vepër,
...pas fjalës së thënë rëndë,
...pas një të shëmtuare, vallë,
...pas sedres së plagosur e t'vrarë,
...e madhe, e vogël ..., e rëndë, e lehtë
...pa matur, pa përshkruar, pa emër..., në letër.

Mes

Mes lulesh e gjelbërimesh
mes njerëzish e fjalësh
një herë nën hije, dy nën diell
një here nën strehë, dy nën të... i varur .
mes hapash i shkelur
mes fjalësh i përbuzur
një herë i gëzuar, dy i hidhëruar
një herë i qeshur, dy i përqeshur .
mes të mirave i stërkequr
mes të bukurave, i shëmtuar
një herë shëmbëllen, dy i mërrolur
një herë i ëmbël, dy i hidhur.
mes gëzimit, i pikëlluar
mes heshtjes, i trazuar
herë ashtu, herë kështu
asnjëherë i pushuar.
...gjerë kurë kështu a thua?!

Prehja

***P**ara të gjallëve, i gjallë*
Për vetëveten, jo i gjallë
Për të tjerët, shpresë e fjalë
Për vetëveten, hije falë.

Nata ikë në gjumë, pa dije
Dita fillon, me lojë mërzie
Si një pikë, pjesë galaksie
Si një thërrmi, gravitacioni t'shpie.

Kërkon vendprehje në qiell e tokë
Mendje e trup, pushton amullia
Heshtur farë e fis, miqë edhe shokë
Gjymtyrë e kokë, pushton mërzia.

Tokë e qiell, hënë e diell
Duar e këmbë, sy e veshë
Peshë janë trazuar e këndjellë
Çdo gjë me njëra-tjetrën ndeshë

Malli e loti, strukur n'thellësi
E tëra huq e kot, prehjen se gjen dot
Lënduar e vrarë, zemër e sy
Jetë e motë, në këtë e atë botë.

Loti, malli, prehja, …enigmë!

Askush

***Gj**ithësia, bota, njeriu*
Pleqësi shumë e vjetër.
Njeriu në botë,
Bota në gjithësi...
Sa vjetërsi?
Njeriu, bota, gjithësia,
Të tëra në lëvizje!
Sa lëvizje?
Sa shpejtësi?
… kahja !?
Askund, askush,
S'tregon t'vërtetën.
Bredhë udhëkryqeve të dyshimit.
… deri ku, gjer kurë?
Spjegimet edhe më tej rëndojnë
Udhëkryqet edhe më tej shtohen
Jashtë dëshirës, jashtë vullnetit,
Askush nuk di rolin e të brengosurit.

Etja

Sh*pirtin e trazuar*
Malli i vetmisë
Trishtueshëm kishte zotëruar
Zemrën e etur t'djalërisë
Diku larg në bredhje
Gjysë shterur, gjysë tharë
Për t'bukurën
Me dashuri prehej.
Pa të !?
I shtohej zbehja
Lehtë pushtohej
Gjysë vdekur, gjysë gjallë
Sy stërkuqur, ngjyrë qielli
Stërngarkuar e mbushur mallë
Si ujor, n'dhe t'kulluar
...dehidruar
Gjysë gjallë, ndërvete pështëriste
Luleshpirtin, rrishtaz përfliste.
Për ate !
Përvidhur nga dielli
Alivanosur nga etja
Dhimbshëm buzëqeshur
Të dashurat lule përrreth
Lule mallin
Të vet'min ushqim kishte
Vetëm sa gjallë të ishte

Ajo dhe ata, shpirt i falnin.
Për t'i matur, etjes elanin
Etja, vallzonte ritmin
Nën diell, e nën hënë
...atje diku largë!

Etja, armik i shpirtit të gjallë!

Athua

***Sh**umë ndryshime*
Në natyrë, e në këtë hapsirë,
A thua pse?!
Shumë ndryshime jashtë,
Shumë e më shumë brenda,
A thua dëshirë e kujt është... ?!
Asnjë porosi e Zotit të Madh
Asnjë njeri nuk ka këso obligime,
A thua kush... ?!
Natyra, pa fjalë,
Shumëçka rrëfen,
Njeriu pa rrëfyer,
Shumëçka gënjen.
A thua ç'po ngjetë... ?!
Kafshët anembanë,
Njerëzit poashtu,
A thua cili, prej cilit ikë...?!
Në etër lëshohen e barten porosi,
Aroma nga natyra, fjalët nga njerëzit,
A thua si gjendet fajtori ?!
Koha kalëron para nesh,
Shumëçka shkatrimthi në ne,
A thua edhe sa kështu?!

Rrëmuja

Çastet e vetmisë,
qofshin të mallkuara,
Kur qiellin kaplojnë rretë.

Çastet e hamendjes,
qofshin të vërshuara,
Kur erërat tërbohen në qiell.

Çastet e pikëllimit,
qofshin të pashijuara
Kur lules rehatinë nuk i lënë.

Yjet e natës, po edhe dielli i ditës,
Nata dhe dita... pra,
Shpirtit rrëmujën i kanë vënë.

Mbi

***M**bi t'bukurin*
Truallë timin
Shumëngjyrësh,
E shije plotë
Pa ndalur
Të reja lule mbinë
Aromë e pasur
Gjithnji e njomë
Lavdi shekujsh, kundërmojnë.
Bukuri
Që kush nuk ka
Lakmi,
Që çdokujt i shton.
Mbi të gjitha
Vendi im!

Për...

Mes lulesh, mes lisash
Mes aromash, e ngjyrash mozaik
Shumë therra shqetësimin zgjuan
Mërrola fytyrës mbollën
Shëmtimin syve dhuruan
Pa dashur, pa ditur
Dashurinë ngulfatën.
Për t'mos jetuar bashkë
Për t'mos jetuar buzëqeshur
Për t'mos... përjetuar lumturin!

Lejo

Më thuaj të vërtetën
Zemrën ngushëllo
Bredhjet e kota
Mundojnë sedrën
Fytyrës së njomë
Harren fali.
Sytë kaltrosh këtë adhurojnë
Mërrolat ballit
Buzëqeshja i vretë
Bukuria hovin le të merrë
Diellrrezet le të shkëlqejnë
Lejo gëzimin
Anembanë, le të derdhet
Shijo rininë, kupto pjekurinë
Shfreno mendimet
Përjetimin kultivo...
Flutura n'lule t'çelur pushon!

Buzë liqenit

Nj*ë pasdite të vonuar*
Buzë liqeni të përgjumur
Ulur n'shkëmbin gjysmëlagur
Sy e veshë, i vetmuar
Në shikim dielli t'përgjysmuar
Shtrirë, shpërndarë rrezekuq
Mbi liqen, pushimin bënte
Këndshëm plotë simfoni
Valëliqeni, në vallëzim
Rrezedielli e valëliqeni
Ndriçuari puthitur xixëllonin
Gjilpërë, zemrën shponin
Të gjallin, fluturonin...
Të vdekurin, gjallëronin...
Buzë liqenit...
Rrezet e t'perënduarit të praruar!

Lulja

Nën qiell të hapur,
Në livadhin e nën diellit,
Vallëzonte gjethëhapur,
Lulja e nënqiellit.
Trupëfildish dridhej,
Buzëqeshur me ngjyra
Bleruar, ëmbël përvidhej
Përdredhur, n'shumë mënyra.
Pushonte shikim, rrethit natyrë
Askë si vetja nuk kishte,
Askund-krijesë më të mirë,
Për të pushuar s'kishte.
Sikur të isha truall,
Apo ajër, rreth saj,
Rrënjët t'i mbaja në duar,
Ëmbël të puthja, e të vdisja pastaj.

Syri im

***M**ërzi*
***Ë**ndërr*
***R**rugëve të këqija*
***G**rindje,*
***I**ritim,*
***M**ahnitje,*
***I**ntrig,*
*… është or vëlla, **M**ërgimi!!!*

I mërzitur,
I ëndërruar,
I rrugëve,
I grindur,
I irituar,
I mahnitur,
I intriguar
*… është or vëlla, **MËRGIMTARI!!!***

Fjalë të amanetit

Kur u nisa për me dalë,
Më përcolli një plakë e vjetër
E moshuar, rrudha balli
Mezi m'fliste me zemër malli
Loti i rridhte deri në mjekër
Nuk di bir, me t'shkru n'letër
Dua t'them, fjalë amaneti
Sa e sa kohë i ruaj n'veti.
Buza m'dridhet,
S'më mba gajreti
Shumë selam, mi bën djalit
Që m'vodhi i ziu gurbeti.
"Anekënd, për të dëgjoj
N'gjumë prore trishtoj.
Me shumëçka ma paskan munduar
Atë që mësoi nga djepi
Gadi sa nuk i paskan haruar
Sytë iu paskan verbuar
T'folmen m'i paskan, ndryshuar…
Me e ditë bir se njëashtu është
Me më rrjep për së gjallë
Gjinin tim s'ta bëj hallall"
Se gjithnji, na kanë munduar
Më se e vërtetë është…

Por asnjëherë, s'jemi dorëzuar.
Në më të madhin gazep
Ndër shekuj jemi dëshmuar
Atdhetarë të vërtetë!
E besa bir, pa u bashkuar
Lokja yte nuk do të vdes.
Ditët, varg zinxhiri
Shenja, kujtim lënë
Njëra pas tjetrës, rrudhat
Lëkurën kanë vrazhdur,
Secila, porosi n'vete
Forcuar një nga një,
Ndërruar m'ka ngjyrën
Thonjtë në gishta zgjatur
Shëmtuar për t'më parë,
Nga e gjalla mërzi e gjatë
Si pranvera natyrën
Floku mbuluar m'ka fytyrën
Zemra lidhur e shtërnguar
Për fushë e malë
Shkëmb e gurë
Për lëndinë e arë
Bedem e kulm, me flamur
Me to, jetësuar këmbë e duar
Për liri... deri në varë!

Halli i mërgimtarit

Ç'peshë e rëndë qenka,
kur s'di ç'të peshon.
Hallë vetes s'ju bëka,
Anembanë, gjilpëra t'shpojnë.
Dhembje t'çuditshme ndjej,
T'eshtrave t'thyera.
T'fshehura që s'mund t'i vërej,
T'përcjellura me t'qara.
N' thellësi deti apo lartësi qielli,
Medituari zhdukesh.
Si rrezet dhe diellli,
Si bariu e fyelli,
Përmallshëm i humbur.
I harruar nga vatra,
Futur në kujtime,
Arrin, shkel e shkelmon,
Qesh apo qan,
N'vend të huaj
Askush nuk t'vrojton.
Zemrës, duket i del flaka
Askush nuk t'beson
Si mendon e ç'tmundon.
Të vërtetët...
Ata që të duan, ata që i don.
Fare nuk i sheh, fare nuk i dëgjon,
Për të qenë, pët të egzistuar
Me vuajtjen lufton.

Padashje, ofshamat jehojnë.
Mundohesh...
Mendon të t'ndihmojnë.
Hidhërohesh...
Ngatërruari çdo gjë t'shkon.
Shpirtin, tërmete pushtojnë.
Rrugëkryqe, gjithnji shtohen
Në këtë apo atë, mos u hidhëro.
Motër e vëlla, mallin mirëkupto
Mërgimtari, pa kuptuar mbetet
Prushë e zjarë, malli për fëmijë.
Halli i megimtarit, e gjallë mërzi...!

Bota dhe njeriu

***Bo**ta dhe njeriu,*
Shumë të vjetër janë.
Pleqësinë e tyre,
Askush s'tregon me saktësi.
Një thotë miliona,
Mijëra vite, tjetri.
Sado që të jetë,
Nuk është me rëndësi.
Por ç'ka ndodhur me to,
Duhet ditur, i rritur e fëmijë
Detyrë e secilit njeri, patjetër
Nëse sot jo, doemos nesër,
Obligim gjithmonë mësimin.
Të njohim të vërtetën
Vetëveten e rrethin
Botën dhe njerëzimin.
Të duam njëri tjetrin,
... dhe shkruar në letër.
Obligim nga Zoti!

Jeta

S'di a më dëgjon kush
Vallë zëri, m'është shterrur
Sa shumë që bërtas
Fyt e damarë, m'fryhet
Sa nuk kanë pëlcitur
Stërritur e stërvarur
Pareshtur veshi dridhet
Çfarë duhet bërë vallë
Dikush t'më përgjigjet
Hapur gjithmonë syri
Përplotë etje e mallë
Shikon, si është më së miri
Rrethë e qarkë, hije marrë
Njëra pas tjetrës
Rrudhat forcuar
Ballin rritur kanë
N'gishta thonjtë lakuar
Trashur e zgjatur janë
Vrazhdësi e lëkurzbehur
Flokërënë e thinjur
T'gjitha porosi dërgojnë
Truri njëlloj vazhdon
Asgjë nuk heton...
vijon... e shkreta pleqëri!

Takim i trazuar

***M**bi atlasin e kësaj bote,*
Në planetin e simfonisë,
Pa parë, rrethuar me etër.
Rrënduar më kishte, pesha e mërzisë.
Vëllimi, një pikë në hapësirë
Masa, i tejkalonte peshën galaksisë.
Mundja dhe plogështia...
Shtrënguar, shtrirë më mbanin,
I tillë, dhunuar qëndroja,
diç e pazbuluar më rëndonte,
t'palëvizur, t'pamundur, t'pavlerë,
për vete e të tjerë.
Diç e panjohur,
mes kthetrash, më mbante.
Rol t'padëshiruar, gjatë kohë, po luaja.
I vetmuar, askënd nuk shihja.
S'di kush a më shihte
Valë t'shkumbuara, dëgjoja!
Kënaqesha, duke pritur e përcjellur,
lindjen e diellit të trazuar,
t'perënduarit e tij magjik.
Rrezet e tij të derdhura,
në t'puthura të detit,
Takim malli trazuar, shkëlqente!

Dyshimi

Ka shumë kohë
S'di as vetë sa
Kërkoj të shprehem
buzët më ngjiten
mundohem të shkruaj
zemra m'ligështohet
gishtat dridhen
s'di përse...?!
Gjithherë i akuzuar
pse s'më sheh
pse s'më prekë
Gjithëherë gishtin
Kah unë drejtuar
pse aq larg?!
Vallë fshihesh
apo me qëllim ik?!
Kështu apo ashtu
fjalë sa të duash…!
Asgjë s'ka, pos dyshim
asgjë, pos përmallim
Sado larg që jam apo do të jem,
...ndonjëherë
flas e bëj me zemër
më shumë se çdoherë.

Ishte

Ishte natë,
fund maji.
Freskia,
përnjëherë u zhduk.
Sikur t'mos ishte,
…hidhërueshëm,
sikur t'mos kthehej më.

Me të, ikën… të gjitha!

Një jetë kemi

***K**ërkoj kohë të rehatshme*
Kërkoj vend të përshtatshëm
Folenë time të ndërtojë
Zogjve këngën lirshëm t'ua dëgjojë
Sipas ligjit të trashëguar
Vese t'natyrës të shijojmë
Siç dimë e siç duam
Askënd pa lënduar
Ballë për ballë me dhuntitë e Zotit
Gjuhë për gjuhë me krijesat e tij
Mirësia mbi binarë të zhvillohet
Unë të bëhem ti, ti të bëhesh unë
Lartë apo poshtë,
Mbi ose nën
Njësh të ndjehemi
Deri sa të jemi
Kështu apo ashtu
Krijesë e Krijuesit jemi
Një jetë kemi
Ndryshe nuk mundemi
Mirësisë, kufi t'mos i lejojmë
Kënaqësi peisazhesh të gëzojmë
Zenitin e lumturisë të shijojmë
Koha me vrap kalon
Unë dhe ti, një jetë kemi.

E tëra

***Një** shtatori lirie të freskët*
Në një vend të bukur
Qytet zemër tradite
Mallëngjyeshëm, por të buzëqeshur
U njohtuam rastësisht
Shumëçka, me vite ngjeshur
Thoshim mes vete...
Dikur…
Ky ka qenë një vend
Me një gjuhë
Një traditë e një kulturë
Më pas...
Diç më ndryshe,
Gjysëm kështu, gjysëm ashtu
E më vonë...
E tëra ndryshe
Çdo gjë e ndarë jo natyrshëm
Së fundi...
E tëra u përdëftua
U rikthye buzagaz
E tëra, shëmbëllen në gjithëkënd
Ribashkohet gjaku, i ndarë dikur.

Çaste kujtimi

Ndër vite e dekada
Pluhuruar, n'mua vjetëruar
Fshehtas ngacmohet plaga
Fjala, në luftë me gjuhë t'përvëluar
Shpirt e trup pushton flaka
Hë dje, hë tani, të them assesi
Lutje bëj zemrës, pulsimin t'qetësoj
T'më falë pak kohë, disi
Një herë tjetër, premtoj
Të forcohem pak
Gjuhë e zemër t'pajtoj
Të tërën do t'tregoj
Një kohë mirë e matur
Folur e thënë ndër vete
Pa rrëfyer n'vendë t'duhur
Netëve zgjuar e pa gjumë
Dëgjuar, lexuar të parët
Mësuar, kuptuar ndër rreshta
Shprehur,shkruar nën qirinjë
Ushqenim këndshëm,tonën rini...

Lartë

***D**ikur, një kohë*
në një vend të caktuar
mbledhur kuvendonin
se si duhet vepruar?!
Sytë qenkan verbuar
shqisat çrregulluar
shija e hidhur, nuhatja e qelbur
Si duket, rruga mjegulluar
gjuha e butë, qenka forcuar
e fjala e ëmbël qenka strukur
Pse? Dhe...vetëm pse?
Gjithnjë, or njeri, kujdesu!
Kujdesu, mos të humbësh diç,
diç që Zoti i Madhëruar, të fali.
Kujdesu dhe ngritu lartë,
në piedestalin e çiltërsisë së ngritur
kurorën e t'bukurës dhe vlerës së ndritur.

Malli

***I** ulur pranë dritares,*
natyrën me ëndje shikoj.
Bukuritë e shumta të pranverës,
Kujtime të së kaluarës shfletoj.
Në mesin e gjelbëruar,
ëmbël, një lule buzëqesh.
Pandehem si n'gjumë, ëndërruar,
me shpirtin trazuar peshë.
Ulur, i shtangur lulet shikoj,
me sa forcë që kam, krahët shtërngoj.
Oh, sa fortë që dua, njëherë t'a përqafoj,
kështu prej së largu, nuk mund të durojë.
Lulja buzëqeshur, fuqishëm kundërmon,
Zemrës së ndezur, mallin zgjon.
Era e përcjellur, dërgon porosi
Egon e saj, çuditshëm trumbeton.
Malli ndër veti mbrojtur me mjeshtëri
Fuqin ushqen me ëndje ngadalë
Shfaqur e shpërthyer, në dashuri i tëri
Po si lumë-gurrë, shndëruar në lavë.

Pranë sofrës

Andej e këndej,
anekënd ecte gjaku im.
Nga gjëmimet e topave vrasës,
flaka e baroti përbindësh.
Me plaçka këmbëzbathur
shtigjeve të rrezediellit
t'pëgjakur e t'përlotur,
të sharë e të vrarë.
Përsëri, përsëri e përsëritur
Herë kah jugu, herë kah veriu,
herë kah lindja, herë kah perëndimi.
Herë andej, herë këndej
Mes shumë peripetish,
mes shumë kufijshë.
Lloj-lloj kontrolluesish n'mes
Përsëri, përsëri e përsëritur
Buzagaz e krahëhapur, në pritje t'gjakut.
Veshjembathje, shtrat e mbulesë
Bukë, krip e zemër, kafshatën ndajmë
Me qeshje vuajtjesh pranë sofrës tubuar
Shpirtin djegur e përvëluar
Njëri tjetrin ngushëlluar
"Të qarit s'është traditë e jonë.
Pranë sofrës së shtruar
zemër gjërë kujdesshëm, ëmbël flasim.

Nga gjiri s'duhet ndarë,
Hapat e kohës do t'ndjekim.
Çerdhe e shkollë do zhvillojmë,
Çdo gjë s'bashku do mësojmë,
Jemi të stërvitur, s'na bën gjë dot
T' keqen nga vetja do largojmë
Syri nuk do të derdhë lotë..."
Motra e vëllezër, një fis një gjakë
Zemërbardhë, bujarë, gojëmbël plotë
Pranë sofrës, shtruar me mallë
Zemrat e lënduara ngushëllojnë,
Fjalë të zgjedhura, mjaltë e kajmakë.
(Pranë sofrës në Prizrenin historik.)

Kënga e gëzimit

*Ë**shë shumë e gjatë*
kërkuar nga të gjithë
kënduar, kudo e çdo kohë
Në rini e pleqëri, tek çdo i gjallë
Tek unë, ai, ajo, ne dhe ata
secili që frymon, atë adhuron.

Buron në fëmijëri
gjallëron në rini
Përsoset në pjekuri
mbaron në pleqëri
Tek unë, ai, ajo, ne apo ata
Melodi e lehtë, shpejtë mësohet
Këtu e atje, gjëkund ku dashuri ka
Buçet dhe jehon, kënga forcohet...

Oda e gëzimit rrjedhshëm këndohet
Rrjedhshëm e ëmbël dëgjohet
Art e vlerë, e mendjes së ndritur
Paqë mbjellë, mirëqenie korrë
Amanet pë të rritur, është secili i mitur!

Zogu i natës

***H**eshtje. Natë është,*
Tmerrshëm terri ka kapluar.
Askush zgjuar, nuk është,
vetëm zogu i natës, i vetmuar.
Heshtje. Tingull i vetëm s'dëgjohet.
Errësira çdo gjë ka tretur,
vetëm zogu i natës…mendohet.
Si, vetëm ka mbetur.
Heshtje. Asgjë nuk shihet.
Terri, n'gji t'vetin ka fshehur.
Gjithçka pas dritës fshihet.
Eh, zogu i natës, i mjerri, shkon duke u tretur.
Ngritem në këmbë, ndërpres heshtjen.
Hap dritaren dhe në të qëndroj,
yjet e qiellit, aty - këtu numëroj.
Numëroj, numëroj dhe në vete buzëqeshem.
I papunë.
Marr lapsin në dorë,
letrën e pastër afroj,
për të shkruar mendoj,
por prap, s'di nga dhe si të filloj.
Ulem. Përsëri në të njejtin vend.
Heshtja më mundon.
Zogu i natës, o i ngrati shpend,
pse ashtu po vepron!?

Rastësia

***N**doshta rastësisht jemi të gjallë,*
ndoshta rastësisht jemi në lëvizje,
sidoqoftë, sido që të jetë,
jo rastësisht është njohtimi…!

Aty apo këtu, kudo që të jesh,
andej apo këndej, ndonjë kufiri.
Aty ku mbinë e ndizen ndjenjat,
Aty duhet kultivuar e shuar.

Nuk duhet shumëçka blerë
Mjafton sinjali i syrit
Nga sedra përcjellë
Andej apo këndej kufirit
rit mërzinë, vepro me zellë.

Rrëfimi i lumit

***L**umi i gjërë, i gjatë, gjarpërorë,*
me emrin e bukur e shekullor.
"Valëbardhë", valë - valë,
për çdo ditë rrëfen me mall,
prej së linduri
e sa është gjallë;
nga burimi,
e deri në gji.
Për shtratin dhe brigjet e tij,
për rrugën gurërore, fqinjët përreth,
me të cilët së bashku,
shumë kohë bredhë.
"Prej atëherë e deri më sot,
kohë shumë e gjatë.
Po të filloja nuk do të mbaroja dot,
gjithë atë që përjetova
dhe po përjetojë…
se dikur jetoja më mirë,
me shumëçka mund t'ju vërtetojë.

Rruga ime ishte e qetë,
me shtrat shkëlqyes,
me brigje të buzëqeshura,
me çiltërsi të valëve të bardha,
jehoja anembanë.
Më donin e i doja,
brenda dhe pranë."

Ndiqni fjalët e bëni kujdes,
gjithçka do t'ju dhurojë,
deri sa t'jem gjallë e të vdesë!

Burgu i adhuruar

***M**allkoj kohën në kalim,*
urrej "tik-takun"e orës në shpejtim,
që rrishtaz mallin mban në zgjim
…prehje, ngushëllim shpirti e zemre.
Fjalët e zëri yt i ëmbël,
buzët dhe floku yt i butë.
Qëndrimi, lëvizja e lehtë,
çiltërsi shpirtërore, bukuri…
Ata kanë burgosur dashurinë
në muret e pamposhtur të kësaj zemre,
që dëshmi kanë më parë vdekjen, se mposhtjen.
Ata kanë hapur burgun tënd të përjetshëm,
ku gjumi është më hyjnorë se zgjimi.
…cakrroj gotën e përgëzimit,
me duar të kryqëzuara,
ngjallin klithmat e zemrës nga thellësia e burgut,
magji e vërtetë…
Pa folur kuptohesh,
pa luftuar fiton botën,
pa ecur arrinë piedestalin...
zgjimi e gjumi n'dyluftim.
"Burgu i adhuruar"në gjumë!

Biseda –plus

***N**ën hije të një shelgu,*
pranë lumit freskues,
në gjelbërimin e blertë,
gjaku e zemra bëjnë bisedë.
Biseda dyshe kundërmon
nga epshi që zgjon.
Dëshirojë dëfrim,
prekje e puthje,
prej flokut e deri në lëkurë,
me majet e gishtërinjëve të butë.
Me buzët e ëmbla e të lëngëta
si bleta mbi nektarin e lules,
të thithë ngadalë e lehtë,
që çdo qëndër dashurie të rrënqeth.
Ledhatuar flokun,
rrugët damarë,
syrin kaltërosh të ushqej,
me ëmbëlsirën që ndjej.
Të prek lëkurën tënde,
të butë e të njomë.
T'shëtis dalëngadalë,
margaritarë mbi oqean,
shoqëruar me yje dhe hënë.

Fjalët e zemrës

***N**ga të çarat e mjegullave të zeza,*
prisja dritën të shëndrrisë,
shkëndinë dhe rrezet e nxehta
nga dielli i gjithësisë…
…që zemrës t'i falë trimërinë.

Kohë pas kohe shikoja në dritare e derë,
prisja me mallë, shoqërimin me të.
Mezi duroja, me nderë;
të përmbysë vetminë e shpirtit në të…
…që zemrës t'i falë dashurinë.

Çast pas çasti i flisja zemrës,
shpirtit tim të trazuar,
e ngushëlloja me fjalët e lules,
me shijen dhe erën e saj, për të freskuar…
…vetëm e vetëm t'i falë dashurinë.

Nuk mundem, nuk duroj dot…!
Me mall, më përgjigjej zemra,
…pse kështu vepron me mua jeta; pse…?
më thoshte prore,…si kështu u gjeta?
…mos më le, mos më largo nga dashuria.

Nuk kam pse të jetoj pa ty,

pa ty s'kam dashuri…, e as puthje,
më thahen buzët… pa nektarin tënd mjalte,
gjinjtë dhe gjaku…kërkojnë,
…që zemrën t'a gjallërojnë.

Shpresë

***Ç**'peshë m'rëndon trupin,*
shtypur pa masë kokën më ka.
Ç'mjegull e dendur rrethuar,
më ka mbyllur sytë,
dhe shtypur fortë m'i m'ba.
Mundohem medituari,
rrugë,rrugë përplotë pafundësi.
Forcë e humbur,
e tretur,
pa tru dhe sy mbetur.
Drejtë fundit të pafundësisë,
pa dashje, pa zemër m'përmbys,
Thoni i ngulitur për dhe,
Shpresë e fundit e gjallërisë.

Shokut tim - shoqërisë sime

Kur dy shokë, rastësisht takohen,
e jo, rastësisht vazhdojnë shoqërinë,
të tillë, me siguri, mbeten deri në fund!

Fjala shokë baraz me një jetë:
e gjatë dhe e gjërë,
e ëmbla, ndarë me të hidhurën…
shokë, gjithçka, pra!!!
Pason pyetje nga dikush
"Pse"?
Pyetje shumë e shkurtër!
Tre shkronja, në gjuhën time,
përgjigje shumë e gjatë dhe e pa fund,
sërish nga gjuha ime!

Ja pse!
Shok, një jetë është.
Si kuptohet dhe udhëhiqet jeta,
ashtu duhet kuptuar shoku dhe vetëvdekja.

Të kultivosh shoqëri, do të thotë,
lule dhe mirësi,…
…prandaj të mundohemi
është e vetmja-ime porosi!

Ëndrra në mjegull

Nj*ë mëngjesi t'freskët,*
në një vend të bukur,
gjumi më zgjoi shpejt,
por disi, i humbur.

I shtrirë mbi shtrat,
vëzhgoj rreth e qark.
Nga brënda, s'më linte diç rehat,
më shtirej, se koka shtrihej mbi gjak.

Mendime plakash, në vehte përsërisja
S'ka të bën me t'vjetrën, vetes i thashë.
E kaluara-gjak, s'ka në mua vend,
por edhe e ardhmja, aspak s'më trembë.

N'dyluftim, tërë ditën gati bëra,
të flas me ato që i dua, shumë u mundova.
Nga kthetrat e saja, s'më lëshonte ëndrra,
zemërthyer me falje, prej tyre u largova.

Largë nga gjiri isha, edhe më largë mbeta,
Mblodha disi veten, mu shtua forca,
Nga jehona ftesë, që dërgonte trumbeta,
Qëndro krenar më tha, gëzimin, ty ta jep toka.

Ftesa kreshnike, shpirtin ma forcoi,
çdo gjë para vetes, më bëri të qartë.
Vendin e prehjes, syve ua dhuroi,
pushimorja e dëshmorëve, më fali dekoratë.

Enigma e zemrës

***P**ër të shkruar e përshkruar,*
Jeta për njeriun bëhet shumë,
...e gjatë, e gjërë, e rrëndë,
Gëzuar, hidhëruar e përmalluar
Askush me të s'ka përfunduar
Brezë pas brezi, shok pas shoku
Me shumëçka përballur
"prej thonit e gjer te floku"
Gjithë këtë ka përjetuar
Deshëm apo s'deshëm,
E kaluara t'vërtetën tregon
Shqetësime, konflikte, luftëra
Prej shigjete, deri në pushkë
Pse?
Me përgjigje apo pa të!?
Po…po!
Përgjigje sepse...
Dashurinë kan vrarë, e harruar,
Për së gjallë verbuar.
Pa konflikt e luftë jetohet,
Së qari, pa buzëqeshje nuk jetohet!
Si Toka me qiellin e amshuar,
njeriu me njerinë, gjithnjë dashuruar.

Më beso

Sa e sa herë…akrepat e orës, shikoj.
Sa e sa herë…datat e kalendarit, numëroj.
Ilaçë nuk ka… gjithë e më tepër, ligështohem
Ngase kohën…prore nuk mund t'a ndalë!

Javët mbushin muaj, e muajt vite,
Koha kalëron…
Mendon se unë kënaqem…
…vetëm se, frymoj!

Valvitem,
Si gjethi i zbehur në shtërngatë
Udhëkryqeve vrasë mendjen
Ngase nuk t'kam pranë
E malli, hidhur helmon!
Prej se kështu u gjeta
Gjumë mu bëftë jeta
Ëndërruari, si lulen-bleta
Beso…të lutem, se t'vretë e vërteta.
Zemra e dashuruar gjithnjë e përvëluar"

Por,ama...

***H**esht, edhe pse në gjumë je*
Tjetrit, i pengon …
Ëndërro, shkriu në të, por i heshtur
Tjetri, aty është mos harro.
Pas ëndrrës, fillon zhgëndrra
Zgjohu, prap i heshtur
Vishu, rregullo veten
Si gjithnjë, krenar
Shëtit e bredh...anekënd
Shiko, mëso pa u ndalë,
pa u ndarë
Mendo, lexo,
shkruaj, duaj,
këndo, vallëzo
Pikturo, skulpturo, aktro,
fol, qeshu, dashuro
…thjesht mos pusho
Por, ama…
I heshtur,
në heshtje
rreth heshtjes,
për heshtjen
Se …
Ajo, shumë flet!
Zgjohu i heshtur,
... mos harro!

Pse o Diell

Anekënd dëgjohen fjalë.
Erdhi e shkoi, pa e parë
I madh e i vogël u bënë përrallë
Si është e mundur kjo punë vallë !?
Po, ka ndodhur, tha më plaku
Shfaqur, dalë e parë
Shkëlqyer por jo rëndom
Kohë e gjatë medituari kaloi
Fëmijë e pleqë,
Hutuar, trullosur
Trembur e trishtuar.
Pse o Diell ?
Parë e pa parë
Të lënduar e të vrarë
Këtu atje, merrej haku
Shpejtë, vrazhdë,
mu si plumb...
Diell, pa ty vdesim
në ty presim,
...kthehu!

Një shpirt

***S**i erë apo ujë nën urë,*
Koha e të gjallit, shpenzohet.
Si llambë apo vajgurë,
Lihet diku, e më pas harrohet.

Gjersa punë bën, pra dikënd shërben
Je...mbi të gjitha
Për laikët...edhe mbi vdekjen.
Pa shërbimin...ikë se të mbyta.

Një jetë, një shpirt është,
Të shërbeu apo i shërbeve
Brenda mundësisë, obligim i yni
Mos pandeh, se dikënd gënjeve.

Lindjen...me gëzim pritëm
Rritjen... buzagaz menduam,
Tani... habitur, shohim me trishtim
Buzëqeshjen e sinqertë, gati harruam.

Një jetë, një shpirt gjithësecili ka
Mërrolur, harreshëm...
Hidhur apo ëmbël...
Sot a nesër, shtrirë ke për të ra!

Për së gjallë

Folmë tani, për së gjallë!
Sa frymëmarrje kam
Thuaj m'dogji xhani
Pastaj... le të më marri.

Përqafomë shtrënguar
Sytë e mi sa t'shikojnë
M'thuaj s'të kam harruar
Pastaj... le të më kujtojnë.

Përshëndetmë ëmbël e zëshëm
Sa veshët t'më dëgjojnë
M'thuaj se je i këndshëm
Pastaj... le të më vajtojnë.

Shtrëngomë me dy duar
Sa shpirti të ndjejë
M'thuaj t'kam dashuruar
Pastaj... le të më shpiejnë.

Këndom fuqishëm e me mallë
Sa zemra prehje kërkon
Falemnderit, për së gjallë
Pastaj... le të më mbulojnë!

Dita yte

Sot, dita yte
E t'bukurës pranverë
Rreze drite, lule plotë erë
E shumëpritur e veçuar
Nënvizuar n'kalendarë
Ditë feste, ditë gëzimi,
Uruar, jetë të mbarë!
Kartolina, peshqeshe
Lumfjalë, rrjedhë si gurra
Shkrime e thënie plotë
Hapen rrugë, lidhen ura...
Shokë,shoqe, familje... pafundë.
Punët pafundë, gëzimet pa kufi
Porosi, më vete bartin
Ushqim, pije... lloj-lloj gota
Reflekto të bukurën, kulturën dhe artin
Flakë të shëmtuarën, vritë golgotën
Përjeto festën, fillim e mbarim
Këngën - këngë, gëzimin - gëzim
Dashakqinjtë, varez kanë bër botën!
Sot, nesër, pasnesër... dita yte
Festojmë e gëzojmë, lartë mbajmë kokën!

Rrugët e jetës

Janë të gjata e gjarpërore
Herë të ngushta e herë të gjëra
Diku prej rëre e diku shkëmbore
Herë të rrafsha e herë të pjerrëta
Diku të buta, diku gjëmbore
Herë të ndritshme e herë të errëta
Në pafundësi zgjaten prore
Herë të lehta, herë të vështira
Andej këndej, lartë e poshtë
Herë të këqia e herë të mira
Sido që të jetë, kudo që të shpie
Hapëro vendosur, e me vetëdije.
Shokë, shoqe o lidhje fisërore
Mos haro, mbajë kujdes
Leje kërko - liri ke
Pyet, për asgjë mos nguro
Lexo, mëso çdo gjë e gjuhë
Në çdo... kohë, sendë e vendë
Dëgjo e respekto çdo kendë
Rrugët duan, rrugët kërkojnë
Të bukurat këshilla familjare
Fjalëbisedë të ëmbël prindërore!
Rrugët e jetës, jeta në rrugë, kuptim në vete!
Liri, paqë, lumturi, do të gjesh kudo!

Nëse…

Nëse diç mungon,
duhet kërkuar,
anembanë, deri në gjetje!

Nëse diç vërren,
me qeshje duhet pranuar,
anembanë deri në vdekje!

Nëse diç, jo në rregull shikon,
përsëri me qeshje vepro, anembanë
deri sa diç rregullon!

Nëse nuk arrin dot, gjë të bësh,
buzëqeshur, gëzimin kultivo,
anembanë deri sa të jetosh!

Mallkuar qoftë gjumi

***P**arreshtur dëgjoj zëra,*
anekënd veshin shpojnë.
Rrethë e rrotullë sillen të tëra,
rrugë askund nuk lënë.
Hë pas njërit, hë pas tjetrit,
hap e vrap e frymëzën,
asnjërin për të zënë,
barazuar jo se jo,
tejkaluar asesi...
Do e zësh... hahaha.
Kush kështu, e kush ashtu,
ca me ironi, e ca me zili,
kush më shumë se tjetri,
gjithë veshë e gojë,
pa sy e tru,
qeshin e tallin të tjerët,
vetë flenë në gjumë.
Më qeshje apo përqeshje.
Të iku apo e zure,
kësisoi po vazhdon...
Zgjuar apo përgjumur,
Kështu koha kalëron,
Vrapo mos ndalo,
Kësaj jetë i thonë!